

Buletini i Taksave

Ernst & Young Albania

Amnistia fiskale diskutohet në parlament

Qeveria shqiptare dërgoi për diskutim në parlament projekt-ligjin shumë të debatuar mbi amnistinë fiskale për subjektet dhe individët. Ky projekt-ligj ofron stimuj për:

- Deklarimin e fondeve të padeklaruar, të cilat do të depozitohen në llogari bankare lokale dhe do të qëndrojnë në Shqipëri për një periudhë të caktuar kohe
- Deklarimin e vlerave aktuale të aseteve
- Raportimin dhe shlyerjen e çdo lloj detyrimi të papaguar tatimor, për sigurimet shoqërore apo doganor

Gjithashtu projekt-ligji përmban dispozita për faljen e borxheve tatimore dhe doganore të konstatuara në vitet e mëparshme.

Duke qënë se projekt-ligji është ende në diskutim, përmbajtja e tij nuk është ende përfundimtare dhe mund të ndryshojë deri në momentin e hyrjes në fuqi. Ne do t'ju mbajmë të informuar rreth çdo ndryshimi të bërë në variantin përfundimtar të ligjit. Më poshtë është një përmbledhje e veçorive kryesore të këtij projekt-ligji.

Përfitimet nga legalizimi i fondeve të padeklaruar dhe rivlerësimi i aseteve

Individët dhe personat fizikë: Tatohen me 3% mbi shumën e deklaruar, tatim që mbahet në burim nga banka lokale ku depozitohen fondet. Pas pagesës së detyrimit, individë nuk mund të mbahet më përgjegjës për tatim të papaguar mbi fondet e deklaruar. Individët mund të rivlerësojnë pronën e tyre të paluajtshme duke paguar tatim me 1% mbi diferencën ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës së kontratës së regjistruar më parë, duke eliminuar kështu çdo detyrim tatimor mbi të ardhurat personale, që mund të lindë prej fitimit nga një shitje e mundshme e pronës.

Afati i deklarimit dhe depozitimit të fondeve në llogaritë bankare lokale është deri më 31 Dhjetor 2011. I njëjti afat kohor vlen dhe për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe pagesën e detyrimit tatimor prej 1%. Pas kësaj date shumat e padeklaruar nuk do të mbrohen nga amnistia.

Kompanitë: Kompanitë mund të rivlerësojnë asetet e tyre fikse me vlerën e tregut (projekt-ligji përmend vetëm pronën e paluajtshme, makineritë dhe pajisjet, por nuk përmend aktivet e patrupëzuara) në pasqyrat e tyre financiare për 2011 dhe të përdorin vlerat e reja për qëllime tatimore. Rivlerësimi bëhet nga ekspertë të pavarur, të licensuar për vlerësimin e pasurisë nga institucionet përkatëse. Diferenca midis vlerës së vjetër dhe rivlerësimit të raportuar do të tautohet me 6% në rastin e pasurive të patundshme dhe 7% në rastin e makinerive dhe pajisjeve, në dallim nga norma standarde e tatimit të kompanive me 10%. Formulimi aktual i ligjit nuk mbulon rastet kur një aset mbahet për qëllim që të shitet brenda 2011.

Kufizimet në transferimin e fondeve të legalizuara jashtë vendit

Nëqoftëse brenda 3 viteve nga data e legalizimit të fondeve nëpërmjet ligjit të amnistisë, ato transferohen jashtë vendit, atëherë mbahen penalitete, të cilat ndryshojnë nëse transferimi do të bëhet në vitin e parë (13% mbi shumën e transferuar), në vitin e dytë (6%), ose në vitin e tretë (3%).

Persona që nuk kanë të drejtë të aplikojnë për amnisti

Zyrtarë të lartë ose të mesëm të pushtetit qëndror dhe lokal, apo drejtuesit e kompanive shtetërore nuk mund të përfitojnë prej amnistisë.

Shlyerja e detyrimeve tatimore dhe doganore të padeklaruar

Tatimpaguesit të cilët nuk kanë deklaruar shumën e plotë të detyrimeve të tyre tatimore për periudhat fiskale deri në fund të 2010, kanë të drejtë deri më 31 dhjetor 2011, të deklarojnë detyrimin e mbetur tatimor dhe të paguajnë vetëm gjysmën e tij, ndërsa interesat dhe gjobat falen plotësisht. Deklarimi dhe shlyerja vullnetare e bërë deri në fund të 2011, pranohen vetëm nëse nuk ka filluar ende kontrolli tatimor përkatës. Rregulla të veçanta zbatohen për biznesin e vogël dhe individët në lidhje me zgjidhjen e detyrimeve tatimore të pashlyera.

Gjithashtu falen gjobat dhe interesat për mospagimin e detyrimeve doganore në lidhje me diferencën midis vlerës reale dhe vlerës së deklaruar fillimisht, për mallrat e importuar deri më 31 dhjetor 2010, kur deklarimi i vlerës së re bëhet vullnetarisht deri më 31 dhjetor 2011. Në qoftë se, gjatë ekzaminimit të mëvonshëm, rezultojnë se vlera është akoma më e lartë, atëherë amnistia nuk do të zbatohet për të gjithë shumën.

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Falen gjobat dhe interesat për kontributet e sigurimeve shoqërore në lidhje me periudhat deri më 31 Dhjetor 2010.

Amnisti për taksat dhe borxhet doganore

Gjysma e shumës së borxheve tatimore të personave juridik dhe të taksapaguesve të tjerë të regjistruar si subjekt i TVSH-së, të konstatuar përpara 2010, falet në qoftë se tatimpaguesi paguan gjysmën tjetër deri në fund të 2011. Borxhet e konstatuar në vitet përpara 2009 falen plotësisht. Kusht për falje të plotë apo të pjesshme të borxhit është që tatimpaguesi të pranojë se kërkesat që ai mund të ketë për rimbursim apo kreditim tatimi, të zvogëlohen në vlerë të barabartë me shumën e detyrimit tatimor të falur.

Detyrimet në lidhje me borxhet doganore për periudhat deri në fund të vitit 2008 falen plotësisht. Gjobat dhe interesat në lidhje me borxhet doganore për 2009 falen në qoftë se paguhet detyrimi.

Çfarë duhet të bëjnë kompanitë:

- ▶ Kompanitë duhet të shqyrtojnë nëse planifikojnë shitje pronash të patundshme në të ardhmen, dhe nëse priten humbje të mjaftueshme tatimore të cilat të mund të përdoren për të kompensuar ndonjë fitim kapital të tatueshëm. Në qoftë se jo, mund të jetë e dobishme për kompanitë të marrin në konsideratë normat e reduktuara tatimore sipas projekt-ligjit të amnistisë për një rivlerësim tatimor efektiv të pronave përpara se të shiten. Duhet thënë se ligji i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri është shumë i kufizuar dhe humbjet mund të mbarten përpara vetëm për 3 vjet me kusht që pronësia të mos ketë ndryshuar.

Megjithatë, shitjet që ndodhin brenda 2011 nuk mund të përfitojnë nga trajtimi i favorshëm tatimor për rivlerësimin e aseteve, pasi ashtu siç qëndron ligji tani, kërkon që vlera e re që rezultojnë nga vlerësimi të raportohet në pasqyrat financiare të 2011.

- ▶ Kompanitë duhet të shqyrtojnë pozicionet e tyre fiskale për 2010 dhe vitet e mëparshme, për të cilat akoma nuk ka filluar kontrolli tatimor. Kompanitë duhet të llogarisin qëndrueshmërinë e këtij pozicioni përpara një kontrolli tatimor të mundshëm në të ardhmen, apo në qoftë se do të ishte me kosto-eficiente të përfitohej prej ligjit të amnistisë për shlyerjen e taksave të padeklaruar. Vendimi përkatës duhet të merret përpara fundit të 2011 dhe përpara se të fillojë një kontroll tatimor.

Ernst & Young

Assurance | Tax | Transactions | Advisory

Ernst & Young

Ernst & Young është një lider botëror në shërbimet e auditimit, taksave, transaksioneve, dhe konsulencës. Botërisht, Stafin prej 141,000 vetash i bashkojnë vlerat e përbashkëta dhe dedikimi i palekundur drejt cilësisë. Ne krenohemi për ndihmën që ju ofrojmë klienteve tane dhe komuniteteve të ndryshme për të arritur synimet e tyre.

Me emrin Ernst & Young ne i referohemi organizatës botërore të firmave anetare të Ernst & Young Global Limited, ku cdonjës prej tyre është një subjekt i veçantë. Ernst & Young Global Limited, një kompani e bazuar në Britaninë e Madhe, është e limituar nga garanci dhe si e tillë nuk jep shërbime për klientet. Për më shumë informacion për organizatën tonë, ju lutem të vizitoni www.ey.com.

Informacioni i paraqitur në këtë buletin është verifikuar në baze të njohurive dhe pikepamjeve tona me të mira në momentin e daljes në shtyp. Ju lutem kini parasysh se informacioni në këtë buletin nuk duhet të përdoret si konsulence për taksat dhe nuk mund të zëvendësojë keshillimin e konsulentit tane të taksave.

Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni:

Dr. Alexandros Karakitis
Tel: +355 4 241 9571 Ext.111
Cel: +355 69 402 2443
alexandros.karakitis@al.ey.com

Anisa Jasini
Tel: +355 4 241 9575 Ext.131
Cel: +355 69 403 1208
anisa.jasini@al.ey.com

© 2011 Ernst & Young Albania
Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky publikim përmban informacion në formën e një përmbledhjeje, dhe shërben vetëm si një udhëzimi i përgjithshëm. Ky publikim nuk ka për qëllim të zëvendësojë studimin me të detajuar apo opinionin profesional. Jo vetëm Ernst & Young Albania, por asnjë anëtar tjetër i organizatës botërore të Ernst & Young, nuk merr përsipër humbje të shkaktuara nga veprimi apo mos-veprimi i cdo personi si pasojë e materialit të publikuar në këtë buletin. Për cdo ceshtje të veçantë, ju lutem referojuni konsulentit përkatës.